



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR
KRYETARI

Nr. 713/3 Prot.

Shkodër, më 29 / 12 / 2024

Vendim

Nr. 28, Datë 20 / 12 / 2024

“Mbi miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor për Këshillin e Qarkut Shkodër”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoi materialin e përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër, “Mbi miratim e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i buxhetit vjetor për Këshillin e Qarkut Shkodër”, bazuar në nenin 41,77 dhe 78 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, paragrafi VII, neni 33 i Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u *miratua* me *17 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim*;

VENDOSI:

1. Të miratoje Kalendarin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe të buxhetit vjetor 2026, për Këshillin e Qarkut Shkodër, sipas tabelës së bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

